



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 24

Datë: 04. 03. 2021. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. **Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
2. **Shpallja e rezultateve përfundimtare nga QNR-ja, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendine e Kosovës 2021,**
3. **Të ndryshme.**

-
1. **Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

Valdete Daka: E hapim mbledhjen e 24-të të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pra e kemi vetëm një pikë të rendit të ditës e ajo është shpallja e rezultateve përfundimtare nga QNR-ja për zgjedhjet e parakohshme për kuvendin e Kosovës 2021. A ka dikush vërejtje në këtë rend dite? Nëse jo, kush është për këtë rend dite? Aprovohet rendi i ditës...

2. Shpallja e rezultateve përfundimtare nga QNR-ja, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendine e Kosovës 2021:

Valdete Daka: Të nderuar qytetar të Republikës së Kosovës, të nderuar përfaqësues të mediave, mirë se erdhët në shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për kuvendin e Republikës së Kosovës. Në fillim, dua të falënderoj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës brenda dhe jashtë vendit që morën pjesë në zgjedhjet e 14-të Shkurtit dhe shprehën vullnetin e tyre, po ashtu dua ti falënderoj të gjitha institucionet të cilat në ditën e zgjedhjeve kanë qenë të angazhuar dhe kanë ndihmuar organizimin dhe mbarëvajtjen e këtyre zgjedhjeve. Po ashtu një falënderim të veçantë për përfaqësuesit e mediave të cilët kanë qenë me neve gjatë tërë kohës. Pavarësisht sfidave të mëdha mes tyre edhe koha e shkurt, pra në më pak se 40-të ditë në dispozicion të institucionit tonë për të organizuar zgjedhjet. Komisioni Qendror I Zgjedhjeve ka përmbushur detyrimet që ka, duke organizuar zgjedhjet më të mira në historinë e zgjedhjeve të vendit të parë. Pasi që paraprakisht kemi marr të gjitha konfirmimet nga PZAP-ja dhe Gjykata Supreme se pranë këtyre organeve nuk ka ndonjë ankesë e cila do të ndikonte në rezultatin e zgjedhjeve, mund të fillojë me prezantimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për kuvendin e Republikës së Kosovës. Fillimisht fillojmë me statistikat e përgjithshme, pra numri i votuesve të regjistruar ka qenë 1.851.927 votues, numri i votuesve të cilat kanë votuar në secilin vendvotim ka qenë 814.122 votues, numri i votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendvotimit, pra me kusht apo me postë është 89.257 votues, pjesëmarrja në votime është 48.78%, numri i pranuar i fletëvotimeve të vlefshme është 877.503 fletëvotime, numri i fletëvotimeve të pavlefshme është 21.532 fletëvotime dhe numri i fletëvotimeve të zbrasta është 5511 fletëvotime. Rezultatet përfundimtare nga QNR-ja, rezultatet sipas subjekteve: LVV ka marr gjithsej 438.334 vota apo 49.95%, PDK ka marr 148.296 vota apo 16.9%, LDK ka marr 110.978 vota apo 12.64%, AAK ka marr 62.111 vota apo 7.078%, Srbska Lista ka marr 44.404 vota apo 5.06%, NISMA SocialDemokrate ka marr 21.998 vota apo 2.5%, Kosova Demokratik Turk Partisi ka marr 6496 vota apo 0.74%, Ujedinjena Zajednica-Adrijana Hoxhiq ka marr 6422 vota apo 0.73%, Koalicioni VAKAT ka marr 5949 vota apo 0.67%, Romani Iniciativa ka marr 4409 vota apo 0.46%, Iniciativa e re Demokratike e Kosovës ka 3305 vota apo 0.37%, Nova Demokratska Stranka ka 2898 vota apo 0.33%, Social Demokratska Unija ka 2569 vota apo 0.29%, Partia Liberale Egjiptiane ka 2430 vota apo 0.27%, Jedistvena Goranska Partia ka 2162 vota apo 0.24%, Partia e Ashkalinjve për Intergrim ka 2138 vota apo 0.24%, Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës ka 1960 vota apo 0.22%, GI Za Slobodu Pravdu I Opstanak ka 1508 vota apo 0.17%, Nasha Iniciativa 1383 vota apo 0.15%, Lëvizja për Bashkim 1261 vota apo 0.14%, Yenilikçi Turk Hareket Partisi ka 1243 vota apo 0.14%, Lëvizja Përparimtare e Romëve të

Kosovës ka 1208 vota apo 0.13%, FJALA ka 1086 vota apo 0.12%, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës ka 1074 vota apo 0.12%, Koalicija Zajeno ka 1010 vota apo 0.11%, Kosovaki Nevi Romani Partia ka 600 vota apo 0.06%, Srpski Demokratski Savez ka 476 vota apo 0.05% dhe Partia Balliste ka 155 vota apo 0.018%. Janë edhe rezultatet e partive ulëse të cilat I kanë marr partitë në bazë të votave të cilat I kanë marr, pra LVV ka gjithsej 58 ulëse, PDK ka 19 ulëse, LDK ka 15 ulëse, Srbska Lista ka 10 ulëse, AAK 8 ulëse, Kosova Demokratik Turk Partisi 2 ulëse, Romani Iniciativa 2 ulëse, Ujedinjena Zajednica-Adrijana Hoxhiq 1 ulëse, Koalicioni Vakati 1 ulëse, Iniciativa e re Demokratike e Kosovës 1 ulëse, Nova Demokratska Stranka 1 ulëse, Jedinstvena Goranska Partia 1 ulëse dhe Partia e Ashkalinjve për Intergrim 1 ulëse. Vazhdojmë me rezultatet e kandidatëve: LVV - Vjosa Osmani ka gjithsej 300.788 vota, Glauk Konjufca ka 200.641 vota, Arben Vitija 107.813 vota, Donika Gërvalla Schëarz 71.720 vota, Vafije Blair 60.885 vota, Mimoza Kusari Lila 53.563 vota, Avni Dehari 51.116 vota, Armend Muja 44.73 vota, Hekuran Murati 41.176 vota, Haxhi Avdyli 26.630, Saranda Bogujefci 26.378, Faton Peci 25.307, Liburn Aliu 22.551, Arbërije Nagaci 21.800, Labinot Demi Murtezi 19.978 vota, Mefail Bajqinofci 18.815, Shqipe Mehmeti Selimi 18.522, Hajrullah Qeku 17.607, Eman Rrahmani 16.289, Gazmend Dyshinca 16.50 vota, Fitim Haziri 15.951, Alban Hyseni 15.225, Drita Millaku 14.692, Artan Abrashi 14.464, Gani Krasniqi 14.294, Arbër Rexhaj 14.279, Arbreshë Kryeziu Hyseni 14.261, Nijazi Isaku 13.684, Agon Batusha 13.45, Valon Ramadani 13.42, Fitim Uka 12.153, Arjeta Fejza 11.647, Fjolla Ujkani 11.365, Jetmire Vrenezi 11.323, Ardian Gola 11.258, Arjeta Rexhepi 11.253, Adnan Rrustemi 11.234, Rozeta Hajdari 11.209, Doarsa Kica Xhelili 10.604, Fatmir Humolli 10.428, Adriana Matoshi 10.403, Salih Zyba 10.359, Xhelal Sfeqla 10.355, Dimal Basha 10.311, Visar Korenica 10.117, Fatmire Kollqaku 9838, Vendenis Lahu 9832, Jeta Statofci 9410, Luan Aliu 9337, Driton Hyseni 9165, Hinka Kurti 9118, Fitore Pacolli Dalipi 8806, Milazim Salijaj 8488, Arta Bajralia 8428, Besim Muzaqi 8261, Mirlinda Sadiku 7988, Burim Karameta 7802 dhe Haki Abazi 7627. Partia Demokratike e Kosovës - Enver Hoxha 100.518 vota, Uran Ismajli 26.748, Bedri Hamza 24.33, Mërgim Lushtaku 16.317, Memli Krasniqi 15.931, Elmir Reqica 14.487, Berat Shala 14.220, Ardian Kastrati 13.228, Xhavit Haliti 10.562, Bekim Haxhiu 10.234, Eliza Hoxha 10.08, Hajdar Beqa 9954, Ganimete Musliu 9868, Abelard Tahiri 9365, Blerta Deliu 9339, Fadil Nura 9292, Arjana Musliu Shoshi 8183, Adelina Grajinca 7158 dhe Floretë Zenjullahu 6475. Lidhja Demokratike e Kosovës – Avdullah Hoti 69.640, Kujtim Shala 32.700, Lumir Abdixhiku 25.264, Anton Quni 14.840, Armend Zemaj 13.798, Hykmete Bajrami 12.402, Agim Veliu 11.808, Behxhet Pacolli 11.649, Arben Gashi 10.390, Besjan Mustafa 9743, Driton Selmanaj 8818, Marigona Geci 6660, Vlora Dumoshi 6266, Valentina Bunjaku Rexhepi 5775 dhe Rrezarta Krasniqi 5526. Srbska Lista – Sllavko Simiq 19.728, Igorsimiq 19.263, Miljana Nikoliq 18.348, Zoran Mojsilloviq 18.340, Ivan Todosijov 17.980, Verica Qeraniq 15.394, Vranislav Nikoliq 14.499, Millosh Peroviq 14.392, Lubinko Karagjiq 13.804

dhe Jasmina Delić 13.793. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – Ramush Haradinaj 41.406, Daut Haradinaj 13.749, Besnik Tahiri 7815, Bek Berisha 7630, Time Kadrijaj 6804, Pal Lekaj 6629, Albena Reshitaj 5900 dhe Meliza Haradinaj Stublla 4424. Kosova Demokratik Turk Partisi - Fikrim Danka ka 3783 vota dhe Fidan Zhëlltap 2515. Romani Iniciativa – Fadil Gashi ka 1928, Hatixhe Xhorxhoviq 713 vota. Iniciativa e re Demokratike e Kosovës – Elbert Krasniqi ka 2310 vota. Koalicioni VAKAT – Bahrim Shabani 2763 vota. Ujedinjena Zajednica-Adrijana Hoxhiq – Adrijana Hoxhiq ka 5183 vota. Partia e Ashkalive për Integrim – Bekim Arifi 973 vota. Nova Demokratska Stranka – Emilja Rexhepi ka 2097 vota dhe Jedistvena Goranska Partia – Adem Hoxha ka 1375 vota. Këto ishin pra rezultatet pasi që janë mbledhur të gjitha votat brenda Kosovës dhe ato që kanë ardhur me postë dhe me kusht, dhe unë i pyes anëtarët se a ka dikush vërejtje në këto rezultate. Nëse jo, kush është për miratimin e këtyre rezultateve. Faleminderit. I njoftoj të gjithë ata të cilët kanë ndonjë vërejtje eventuale se duke filluar nga tani pra, subjektet politike dhe kandidatët mund të paraqesin ankesat e tyre brenda 24 orëve në panelin zgjedhor për ankesa dhe parashtesa.